



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Dhjetor 2025

Data 23.12.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.11.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Nëntor 2025.
- 3.Projekt Vendim “Për miratimin e nivelit të pagave për funksionaret e zgjedhur e të emëruar,nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026”.
- 4.Projekt Vendim “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës”.
- 5.Projekt Vendim “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027”.
- 6.Projekt Vendim “Për miratimin e projekteve prioritare të investimeve në Bashkinë Vau Dejës për vitin buxhetor 2026”.
- 7.Projekt vendim për disa ndryshime dhe sistemime të Vkb nr.03.datë 29.01.2025”Për rishikimin e Vkb nr.87 datë 23.12.2024 për shtyrjen e afatit të Vkb Vau Dejës nr.71 datë 26.11.2020”Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021” i ndryshuar me VKB nr.64 datë 26.11.2021, lënë në fuqi me VKB nr.78 datë 30.11.2022 dhe ndryshuar me Vkb nr.84 datë 30.11.2023, dhe sipas sugjerimeve të ardhura me shkresën nr.46/4 prot. datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave së Pasurisë(Drejtoria e Metodologjisë dhe ligjore) Tiranë.
- 8.Projekt vendim për lënie në fuqi të nivelit të gjobave sipas VKB nr.65 datë 26.11.2021 “Për vendosje gjobash për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative për vitin 2022” lënë në fuqi me Vkb nr.79 datë 30.11.2022 dhe Vkb nr.85 datë 30.11.2023,Vkb Nr.88 datë23.12.2024 në Bashkinë Vau Dejës.
- 9.Projekt Vendim “Për miratimin e Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës për vitin 2026”.
- 10.Projekt Vendim “Për Miratimin e dhënies së bursës për vitin e parë, në shkollat e arsimit të mesëm profesional, për vitin 2025-2026’.
- 11.Projekt Vendim “Për Miratimin e dhënies së bursës së plotë për vitin e dytë e lart, në shkollat e arsimit të mesëm profesional, për vitin 2025-2026’.



12.Projekt vendim "Për një ndryshim në VKB Nr.73, datë 27.09.2024 për "Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.10860/1 Prot, Datë 13.09.2024, Për Caktimin e Rregullave Bashkëpunimit, Ndërveprimit dhe Koordinimit Midis Ashk-së dhe Bashkisë Vau Dejës në Kuadër të Proceseve të Papërfunduara për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje"

13.Projekt vendim për miratimin e rregullores të komisionit këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret,dhe proceduren e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vau Dejës".

14.Projekt vendim "Për krijimin e këshillit vendor të sigurisë publike në Bashkinë Vau Dejës dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij"

15.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 3.253 ha "Për aerogenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 6 km e 338 m rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gomsiqe dhe Karmë"

16.Projekt vendim "Për miratimin e rinovimit të kontratës së qirasë me nr 1460 prot, datë 16.03.2022, lidhur mes Bashkisë Vau Dejës dhe shoqërisë AlbTelecom sh.a), (sot "ONE Albania sh.a"), për sipërfaqen prej 150 m2, pjesë e pasurisë nr 663, Zk nr 2708, e llojit "Truell", në fshatin Mnelë, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës: "Për ushtrimin e veprimtarisë së antenave të transmetimit të telefonisë celulare të shoqërisë "ONE Albania sh.a".

17.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës finaciare të menjëhershme familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet me datë 26.10.2025, banorë të Bashkisë Vau Dejës.

18.Raporti performances

19.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 23.12.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 20 këshilltarë,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha.), korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Z.Frano Prenga dhe Znj.Franga Kola propozuan që pika 17 e rendit të ditës të mos shqyrtohet këtë mbledhje për arsye se kemi paqartësi në listen e përfituesve, dhe propozojnë që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet mbledhjen e ardhshme.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës pa piken 17.**Miratohet rendi i ditës me 20 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**,sipas propozimit duke mos shqyrtuar këtë mbledhje piken 17 të rendit të ditës.Këshilltarët që votuan pro rendin e ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.11.2025 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 26.11.2025 nga Z.Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha.)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Nëntor 2025.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Dila Pjetri -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se projekt vendimi është hartuar bazuar ne ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Ajo shprehet se projekt vendimi propozon qe 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Nëntor 2025 , familje 130, me 412,787 lekë, me 5.98% e fondit total.

2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Nëntor 2025 janë shpallur fitues, 897 familje, me fond 6,885,536 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 413,132 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt Vendim "Për miratimin e nivelit të pagave për funksionaret e zgjedhur e të emëruar,nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elsa Tanushi-Drejtoresh e zyrës Finance Buxhetit, Bashkia Vau Dejës e cila shpjegon se nga kërkesa e vazhdueshme e këshilltarëve është rritur niveli i pagës së Kryetarit Bashkisë, janë shtuar 3 vende pune edukatore, 3 punonjës të IMT-së si dhe është rritur numri i punonjësve të shërbimeve publike, kjo duke parë nevojat që paraqiten për mbulimin e gjithë territorit të Bashkisë në sektorin e shërbimeve.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro, zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt Vendim "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës".

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Elsa Tanushi-Drejtoresh e zyrës Finance Buxhetit, Bashkia Vau Dejës e cila shpjegon se projekt vendimi i paraqitur bazohet mbi parashikimin e të ardhurave për vitin 2026, transfertat e kushtezuara dhe transfertat sektoriale sipas sektoreve. Gjithashtu është bërë detajimi i buxhetit 2026, bazuar në transfertat sektoriale, kjo sipas vlerave të paraqitura në projekt vendim dhe se buxheti është hartuar konform ligjit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Vërehet se për vitin 2026 propozohet një rritje e vogël e numrit të punonjësve në arsimin parashkollor, IMT dhe punonjës shërbimi në krahasim me vitin 2025, kjo duke ju përshtatur nevojave që ka Bashkia. Të ardhurat e Bashkisë për vitin 2026, parashikohen me rritje.

Gjithashtu në funksion të hartimit të buxhetit për vitin 2026, janë realizuar konsultime me grupet e interesit dhe se pretendimet dhe sygjerimet e ngritura janë marrë në konsideratë.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime, ato u shprehën se jemi njohur me projekt buxhetin.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro, zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt Vendim "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027".

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Elsa Tanushi-Drejtoresh e zyrës Finance Buxhetit, Bashkia Vau Dejës e cila shpjegon se projekt vendimi i paraqitur, lidhur me hartimin e kalendarit të përgatitjes së PBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

per periudhen 2027-2029 dhe buxhetin e vitit 2027, janë respektuar afatet ligjore lidhur me PBA 2027-2029 dhe buxhetin e vitit 2027.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt Vendim "Për miratimin e projekteve prioritare të investimeve në Bashkinë Vau Dejës për vitin buxhetor 2026".

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elsa Tanushi-Drejtoresh e zyrës Finance Buxhetit, Bashkia Vau Dejës e cila shpjegon se projektet prioritare janë listuar si rezultat i dalë nga takimet publike të realizuara me banorët e njësive administrative të Bashkisë dhe këto prioritete janë të lidhura me buxhetin e vitit 2026.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për disa ndryshime dhe sistemime të Vkb nr.03.datë 29.01.2025"Për rishikimin e Vkb nr.87 datë 23.12.2024 për shtyrjen e afatit të Vkb Vau Dejës nr.71 datë 26.11.2020"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021" i ndryshuar me VKB nr.64 datë 26.11.2021, lënë në fuqi me VKB nr.78 datë 30.11.2022 dhe ndryshuar me Vkb nr.84 datë 30.11.2023, dhe sipas sugjerimeve të ardhura me shkresën nr.46/4 prot. datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave së Pasurisë(Drejtoria e Metodologjisë dhe ligjore) Tiranë.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Marije Gjeçaj-përgjegjëse e zyrës tatim taksave Bashkia Vau Dejës e cila raporton për këshilltarët se do të ketë ndryshim vetëm në taksën e pasurisë së paluajtshme, kjo sipas sugjerimeve të ardhura me shkresën nr.46/4 prot. datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave së Pasurisë(Drejtoria e Metodologjisë dhe ligjore) Tiranë.Nivelet e taksave dhe tarifave vendore të tjera do mbeten të pandryshuara.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.



Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e shtatë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për lënie në fuqi të nivelit të gjobave sipas VKB nr.65 datë 26.11.2021 “Për vendosje gjobash për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative për vitin 2022” lënë në fuqi me Vkb nr.79 datë 30.11.2022 dhe Vkb nr.85 datë 30.11.2023,Vkb Nr.88 datë23.12.2024 në Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Marije Gjeçaj-përgjegjëse e zyrës tatim taksave Bashkia Vau Dejës e cila relaton për këshilltarët se për vitin 2026 nuk do të ketë ndryshim të nivelit të gjobave por projekt vendimi paraqitet vetëm për shtyrje afati.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e tetë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:

Projekt Vendim “Për miratimin e Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës për vitin 2026”.

Z Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se janë parashikuar në këtë projekt vendim të gjitha aktivitetet që do të zhvillojë Këshilli Bashkiak gjatë vitit 2026.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e nëntë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:

Projekt Vendim “Për Miratimin e dhënies së bursës për vitin e parë, në shkollat e arsimit të mesëm profesional, për vitin 2025-2026”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Melita Vjerdha-përgjegjëse e zyres arsimit, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se gjatë aplikimit kanë dalë fitues 19 nxënës te vitit të parë të cilët do të trajtohen me bursë për vitin shkollor 2025-2026.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e dhjetë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

Projekt Vendim "Për Miratimin e dhënies së bursës së plotë për vitin e dytë e lart, në shkollat e arsimit të mesëm profesional, për vitin shkollor 2025-2026'.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Melita Vjerdha-përgjegjëse e zyres arsimit, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se gjatë aplikimit kanë dalë fitues 45 nxënës te vitit të dytë e lart për vitin shkollor 2025-2026'

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e njëmbëdhjetë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim"Për një ndryshim në VKB Nr.73, datë 27.09.2024 për "Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.10860/1 Prot, Datë 13.09.2024, Për Caktimin e Rregullave Bashkëpunimit, Ndërveprimit dhe Koordinimit Midis Ashk-së dhe Bashkisë Vau Dejës në Kuadër të Proceseve të Papërfunduara për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje"

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Ersilda Preka- specialiste juriste pranë zyres juridike Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se propozojmë miratimin e Amendimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Nr.6620 Prot, datë 10.11.2025 të Bashkisë Vau Dejës, Nr.13653/2 Prot, datë 26.11.2025 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Këshillit të Bashkisë Vau Dejës "Për caktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat in formale banimi" (Bashkëngjitur shkresa përcjellëse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK dhe Bashkisë Vau Dejës Nr.13653/1 Prot, datë 26.11.2025 administruar pranë Bashkisë Vau Dejës me Nr.6620/2 Prot, datë 02.12.2025).

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e dymbëdhjetë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e trembëdhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e rregullores të komisionit këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret,dhe proceduren e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vau Dejës".

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Ersilda Preka- specialiste juriste pranë zyres juridike Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se ky projekt vendim është konsultuar me publikun dhe ka gjetur dakortësi.

Projektvendimi që ju paraqesim për miratim lidhet me procedurat dhe vendimmarrjen e Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë. Sikurse jeni në dijeni Komisioni Këshillimor aktualisht nuk ka patur një rregullore të miratuar e cila është e domosdoshme për vendimmarrjen e tij por, edhe të Këshillit të Bashkisë. Me këtë rregullore është synuar të krijohen disa standarde në vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë gjatë vlerësimit të personaliteteve të shquara me kontribut në nivel lokal dhe kombëtar. Gjithashtu në këtë rregullore synohet që edhe për emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve ose objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vau i Dejës të ndiqet e njëjta procedurë si për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit. Kjo nënkupton që rregullorja nuk kufizohet vetëm në procedurën e dhënies së Titujve Vendorë të Nderit sikurse parashikohet në dispozitat ligjore për ngritjen e Komisionit Këshillimor. Pra, objektivi është që edhe gjatë emërtimit të rrugëve, shesheve, institucioneve etj, para vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë të bëhet një vlerësim paraprak nga Komisioni Këshillimor, pavarësisht se kjo nuk e kufizon vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e trembëdhjetë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katermbëdhjetë të rendit të ditës:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Projekt vendim "Për krijimin e këshillit vendor të sigurisë publike në Bashkinë Vau Dejës dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij"

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Ersilda Preka- specialiste juriste pranë zyres juridike Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se ky projekt vendim është konsultuar me publikun dhe ka gjetur dakortësi.Këshilli Vendor të Sigurisë Publike i cili do të funksionoi si një organizatë koordinuese, identifikues për problematika që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet.Duke pasur parasysh se zhvillimi ekonomik dhe social i vendit lidhet ngusht me forcimin e sigurisë publike, uljen e kriminalitetit, zbatimin e ligjit, eliminimin e dhunës dhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme, luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm, luftën ndaj kultivimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike apo përballjen me çdo fenomen tjetër krimi dhe paligjshmërie kërkojmë me anë të këtij projekt vendimi të realizojmë ngritjen e KVSP pranë Bashkisë Vau Dejës. Ngritja e Këshillave Vendor të Sigurisë Publike në nivel lokal krijon premisat për një qasje të re strategjike lokale ndaj fenomeneve të pasigurisë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e katërmëdhjetë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Martin Mardoda,Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani,Mirela Vasija,Roberto Trushi,Meliha Zyberaj,Mark Bisha)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 3.253 ha "Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 6 km e 338 m rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gomsiqe dhe Karmë"

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Mark Suli- inxhinjer, specialist pranë zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se propozojmë dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 3.253 ha "Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 6 km e 338 m rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gomsiqe dhe Karmë, pronë e Bashkisë Vau Dejës.Bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika 1.2c, neni 54 pika e/1, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë, dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë. Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik". Siperfaqja e marre në studim do të dale në konkurim publik nëpërmjet procedures së kunkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim "Për miratimin e rinovimit të kontratës së qirasë me nr 1460 prot, datë 16.03.2022, lidhur me Bashkisë Vau Dejës dhe shoqërisë AlbTelecom sh.a), (sot "ONE Albania sh.a"), për sipërfaqen prej 150 m², pjesë e pasurisë nr 663, Zk nr 2708, e llojit "Truall", në fshatin Mnelë, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës: "Për ushtrimin e veprimtarisë së antenave të transmetimit të telefonisë celulare të shoqërisë "ONE Albania sh.a".

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Ndoc Baqli-pergjegjes i zyres aseteve Bashkia Vau Dejës i cili spjeron për këshilltarë se propozojme për rinovim kontrate të "ONE Albania sh.a"), për sipërfaqen prej 150 m², pjesë e pasurisë nr 663, Zk nr 2708, e llojit "Truall", në fshatin Mnelë, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës: "Për ushtrimin e veprimtarisë së antenave të transmetimit të telefonisë celulare të shoqërisë "ONE Albania sh.a", ku në kontratat e mëparshme janë respektuar të gjitha detyrimet ligjore ndaj Bashkisë.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 20 vota Pro zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha)

Pika 17 është hequr nga rendi i ditës.

Z. Ervis Shimaj lexon piken e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës:

Raporti performances së Bashkisë Vau Dejës gjatë vitit 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Aurela Deda – pergjegjese e zyres performances Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se ne kete raport paraqitet një analizë të performancës së bashkisë, duke vlerësuar aspektet kryesore të ofrimit të shërbimeve. Në këtë dokument evidentohen arritjet e deritanishme, si dhe fushat ku nevojitet përmirësim.

Raporti i performances miratohet ne unanimitet me 20 vota pro nga: Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Albina Livadhi, Edona Molla, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Franga Kola, Ornella Lleshi, Martin Mardoda, Arsen Mehmeti, Vjollcë Zagani, Mirela Vasija, Roberto Trushi, Meliha Zyberaj, Mark Bisha

Pika 19. Të ndryshme:

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime nëse kanë meqenëse Kryetari i Bashkisë është prezent.

Këshilltarët nuk kishin diskutime te kjo pikë e rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Deklarohet e mbyllur nga Kryetari Këshillit Mbledhja e Këshillit Bashkiak e datës 23.12.2025,

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CEEPIJA



Këshilltarët:

1. Enis Slimaj
2. Neli Topellari
3. Imri Kalo
4. Frano Prenga
5. Ornela Lleshi
6. Majlinda Nohani
7. Rita Dregi
8. Arsen Mehmeti
9. Mustriot Shkupi
10. Ngjelle Zogaj
11. Eolona Molla
12. Alcina Livaohija
13. Mirela Vasija
14. Besmir Krag
15. Robert Inuli

16. Martin Moroloci
17. Janis Selaj
18. Mark Bishi
19. Melike Zberaj
20. Emir Tolini
21. _____
22. _____
23. _____
24. _____
25. _____
26. _____
27. _____
28. _____
29. _____
30. _____
31. _____